



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 327/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën Partia e Ashkalinve për Integrim (PAI), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalinve të Kosovës (PDAK), dega në Ferizaj, për shkak të dëmtimit të posterave, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Partisë së Ashkalinve për Integrim (PAI), dega Ferizaj, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalinve të Kosovës (PDAK) i shqiptohet dënimi më gjohë në vlerë prej 250 (dyqind e pesëdhjetë) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 23.10.2013, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga PAI, në të cilën theksohet se më datë 16.10.2013 rreth orës 19:10 në fshatin Dubravë është dëmtuar me thikë posteri i kryetarit të PAI-së Asllan Krueziu ku është thyer edhe shtylla me të cilën ishte vendosur posteri. Sipas parashtruesit të ankesës ky rast është paraqitur edhe në polici dhe si i dyshimt është Qazim Rrahmani dhe disa aktivistë të subjektit politik PDAK.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur disa fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik PDAK, me datën 24.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 25.10.2013 në ora 12:00.

Sipas afatit të caktuar PZAP-i, pranoi përgjigjen në ankesë nga PDAK, në të cilën theksohet se subjekti politik PDAK pas marrjes së njoftimit për paraqitjen e kësaj ankese që na është bërë nga ana e subjektit politik PAI, ne themi se nuk jemi pjesë e kësaj vepre dhe emrat e paraqitur në ankesë si dëshmitarë janë familjarë dhe kjo ankesë është bërë shpifje me qëllim që të dëmtohet Qazim Rrahmani. Subjekti politik PDAK në përgjigjen e ofruar thekson se edhe pse në ankesën e subjektit politik PAI thuhet që është lajmëruar policia por deri më tani asgjë konkrete nuk kemi nga policia, por këto ankesa janë të pavërteta.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Sipas parashtruesit të ankesës, PDAK me datën 16.10.2013 në fshatin Dubravë, kanë dëmtuar posterat e kryetarit të PAI-së Asllan Kryeziu, ku me këtë veprim kanë shkelur dispozitat ligjore mbi Zgjedhjet Lokale, neni 33 pika a) dhe Kodin e Mirësjelljes të Subjekteve Politike dhe Kandidatëve të tyre.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Nga fotografitë e ofruara si provë, nga parashtruesi i ankesës, të bashkangjitura shkresës së lëndës, shihet qartë se posterat e Kryetarit të subjektit politik PAI-së Asllan Kryeziu janë të dëmtuara, të cilin veprim PZAP-i, konstaton se është në kundërshtim me dispozitat ligjore të lartcekura.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e PDAK-së është shkelur neni 4.1 pika a) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 të KQZ-së dhe nenin 33 pika a) të LZP-së, pasi që posterat e subjektit politik PAI janë të dëmtuara, si dhe duke pasur parasysh përgjigjen e menjëhershme të subjektit politik PDAK-së, për evitimin e shkeljes së supozuar si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it, nenit 120 paragrafi 1 pika c), si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 327/2013 më datën 25.10.2013.



Kryesuesi i Panelit
Nehat Idrizi

Udhëzim Juridik:

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*